

Data 28.03.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qera tre mjete transporti” për 24 muaj**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Shërbime mbështetëse për transport toksor - 60170000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Fondi limit në total është 9,378,734 lekë pa tvsh.**

Për vitin 2024 është 3,126,245 lekë pa tvsh, për vitin 2025 është 4,689,367 lekë pa tvsh dhe për vitin 2026 është 1,563,122 lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Instituti i Mjekësisë Ligjore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Të ketë në objektin e veprimtarisë së vetë shërbimin objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesi ekstraktin e QKB-së.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet të qëndrueshëm ekonomik gjatë dy viteve të fundit. Për të verifikuar përmbushjen e kësaj kërkesë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, kopje të vërtetuara të bilanceve, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të viteve 2021 dhe 2022.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore, për tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022) ku xhiroja mesatare vjetore të mos jetë me vlerë më të ulët se 40 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kriterit konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë

arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është në kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

## 2.3 Aftësitë teknike:

2.3.1 Furnizime/Shërbime të ngjashme për një vlerë sa 20 % e vlerës së fondit limit (1,875,747 lekë) që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit. Furnizimet/Shërbimet e ngjashme do të vërtetohen duke paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

Në rast se furnizimet/shërbimet janë kryer me ente publike:

Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ENT publik për realizimin e kontratës, fatura tatimore shitje, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave apo llojet e shërbimeve

Në rast se furnizimet/shërbimet janë kryer me sektorin privat:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon fatura tatimore shitje, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave apo llojet e shërbimeve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e

mëparshme të ngjashme të jenë për një vlerë sa 20 % e të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është në kufirin e ulët monetar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë një distributor zyrtar i konsoliduar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 2 ku parashikohet se :

*Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim,*

Kërkesa vlerësohet e rëndësishme për të njohur përvojën e kandidatëve ofertues, me qëllim që fituesi i mundshëm të zotëroje kapacitetet dhe përvojën e duhur në ekzekutimin e shërbimit, objekt i kontratës.

2.3.3 Distributori zyrtar i markës duhet të ofroj :

- Në rast të difekteve teknike të mjeteve ( ndërrime pjesësh konsumi si goma, ferrota, frena, disqe frenash, fshirëse xhami, amortizator, gomina etj.). Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër kryerjen e shërbimeve si dhe në rast se automjeti pëson difekt të pa riparueshëm ta zëvendësoj atë me një automjet tjetër.

**Argumentimi;** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar me qëllim mundësinë e realizimit e shërbimit në kohë dhe në cilësi siç parashikohet në termat e references dhe specifikimeve teknike. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të garandojë brenda vlerës së ofertës së dhënë riparimin e difekteve të automjeteve dhe/ose zëvendësimin e tyre në rast se automjeti pëson difekt të pa riparueshëm.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4 ku parashikohet se : Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë profilin kompanisë ku të japë një përshkrim të detajuar për misionin dhe aktivitetin e subjektit, e shoqëruar me fotografi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë në ofertën e tij penalitetin për kalimin e limitit të km, të ndërrimit gomave, të zevëndësimit e amortizatorëve, të ndërrimit të filtrave dhe vajit të motorrit etj., si edhe të gjitha serviset periodike të nevojshme për tu kryer në mjetet e dhëna me qera.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

**Argumentimi:** Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zoteron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën,

Në nenin 44, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” është parashikuar se; *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sa më sipër kërkesat e përcaktuara në pikat 2.3.4, 2.3.6 dhe 2.3.7 janë vlerësuar si të nevojshme dhe të rëndësishme gjatë realizimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e konformitetit të mjeteve si dhe kontratat/autorizimet nga prodhuesi/distributori, për mjetet e ofruara në momentin e dorëzimit të mallit (automjetit) nga fituesi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 1 ku parashikohet se *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

## **Komisioni i hartimit të dokumentave standarte**